



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITI OF LIPJAN

DREJTORATI PËR INFRASTRUKTURË

Data:	24.04.2026
Për:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës
Kopje:	z.Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës
Nga:	z.Ardian Olluri– Drejtor për Infrastrukturë
Lënda:	Raport për muajin Mars 01.03.2026-30.03.2026

Në bazë të përgjegjësisë dhe kompetencave të Drejtoratit për Infrastrukturë gjatë periudhës prej datës 01.03.2026 deri 31.03.2026, DI ka kryer aktivitetet që ka pasur të planifikuara dhe aktivitetet e veçanta që janë kërkuar sipas dinamikës së zhvilluar dhe kërkesave të parashtruara.
Drejtorati për Infrastrukturë gjatë kësaj jave ka pranuar dhe zgjidhur këto kërkesa:

Pasqyra e lëndëve (kërkesave)				
Nr. i kërkesave të pranuar	Të zgjidhura	Të refuzuara	Në kompetencë	Në procedurë
17	4	5	6	2

Aktivitetet gjatë muajit Mars:

- **Ka përfunduar kontrata për trotuarin Marec-Llugaxhi,**
- **Në trotuarin në Baic vazhdojnë punimet sipas kontratës.**

1. Asfaltimi i rrugicave në fshatrat Llugaxhi dhe Dobraj e Madhe

Kanë vazhduar punimet për rregullimin e rrugicave në Fshatin Dobraj e Madhe, pozicione të cilat është punuar janë: Gërmimi dhe mbushja me material guror i rrugicave në fshatin e lartë cekur.

2. Asfaltimi i rrugicave në fshatrat Bujari, Vërshevc, Leletiq, Magure.

Kontrata është dy vjeçare 2025/2026, kanë vazhduar punimet sipas kontratës, konkretisht është punuar në fshatin Vërshevc, Torinë dhe Magure, është bërë gërmimi i rrugëve, mbushja me material guror dhe ngjeshja.

3. Rregullimi i Trotuareve në Fshatin Kraisht

Është punuar intenzivisht në rregullimin e Trotuarit në Kraisht, kemi filluar nga kroni i fshatit duke vazhduar për në fshat, punimet vazhdojn me intensitet te mire, dhe pritet që projekti të finalizohet para afateve në kontratë.

4. Asfaltimi i rrugicave në Fshatrat: Gadime, Sllovi, Babush, Smallush (Financim i Ministrisë Infrastrukturës)

OE nuk ka vazhduar me punime për realizim të kësaj kontrate, për arsye së ngritjes së çmimit të derivateve!!

5. Asfaltimi i rrugicave në Fshatrat: Babush, Gadime e Eperme

Kanë filluar punimet në fshatin Babush në pozicionet e gërmimit dhe mbushjes me material guror.

6. Ndërtimi I Urës rruga Marie Shllaku (Financim i Ministrisë Infrastrukturës)

Gjatë muajit Mars nuk kanë rifilluar punimet për aryshe atmosferike..

7. Ndërtimi i Qendra Multi funksionale (Shpija Kulturës)

Kanë rifilluar punimet për realizimin të kontratës, kallupimi dhe betonimi i shtyllave të përdheses.

Përgatitja Plani i Prokurimit për vitin 2026

- Është bërë evidentimi i rrugicave në fshatrat: **Hallaq i Madh, Kraisht dhe Mirenë**, dhe janë dërguar për projektim te zyra projektuese “ Studio Hapësira”
- Jemi në proces të evidentimit të rrugicave në Fshatrat: **Shalë, Risinofc etj**, ku gjatë javës tjetër planifikojmë ti dorëzojmë për projektim te zyra projektuese.
- Kemi pranuar projektet për **Rikonstrumin e Rrugës Xhevdet Breznica dhe Pjeter Bogdani**, jemi duke bërë kontrollën finale në paramas dhe projekt.
- **Menaxher i kontratës “ Renovimi i Kulmeve në Institucione Edukativo Arsimore” (Drejtoria e Arsimit)**
- **Komisioni për vlerësim të dëmeve nga reshjet atmosferike Janar 2026 (Vendim i Kryetarit për emërim në Komision)**
- **Menaxher i Kontratës për Eksperten Fatime Sinani (Drejtoria e Urbanizmit)**
- Vizita nëpër fshatra per identifikimin e nevojave për kanalizim Sllovi, Smallushë , Gadime, Bujari.Llugagji, Shalë, Magure, Qylagë,.
- Hartimi i paramasës për klima për Q.P.S.
- Vizitë në teren ures ne Bujari.
- Vizitë në teren ures ne Rubovc.
- Matje te QKMF për hartaim të paramases.
- Hartimi I paramases për inventarë ne QKMF.
- Pritja e palve informimi dhe ojrentimi I tryre .
- Korigjimi I paramasave të kanalizimeve Sllovi, Smallushë , Gadime, Bujari.Llugagji, Shalë, Magure, Qylagë,
- Marrja me kërkesa për qeshtjet pronsore ratet e padive.
- Vizitë në Bau market për hulumti të qmimeve teë tregut.

Komisioni për vlerësim të dëmeve nga reshjet atmosferike Janar 2026 (Vendim i Kryetarit për emërim në Komision)

Gjatë gjithë javës kemi dal në teren në ekonomi familjare për evidentim të dëmeve, po ashtu kemi bërë kompletimin e lendeve në zyre.

Janë kryer procedurat për zotimin e mjeteve te projekteve, të cilat disa kanë qeneë aktive e disa kanë filluar inicimi i procedurave.

- Takimet me projektusin për projekte .
- Puna me palë
- Punë tjera në zyre .

-